

KRIJIMI I PROGRAMIT KOMPJUTERIK PËR DIAGNOSTIFIKIMIN E  
ÇRREGULLIMIT KUFITAR TË PERSONALITETIT TEK FËMIJËT DHE  
ADOLESHENTËT KOSOVAR: EKSPLORIMI I NEVOJAVE TË  
PROFESIONISTËVE TË SHËNDETIT MENDOR

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

Nga:

FJOLLA RAMADANI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

PRISHTINË

KORRIK, 2021

Krijimi i Programit Kompjuterik për Diagnostifikimin e Çrregullimit Kufitar të Personalitetit tek  
Fëmijët dhe Adoleshentët Kosovar: Eksplorimi i Nevojave të  
Profesionistëve të Shëndetit Mendor

Fjolla Ramadani

Mentori: Aliriza Arënliu, Prof. Asoc. Dr

Historikisht, Çrregullimi Kufitar i Personalitetit nuk është diagnostifikuar tek individët e moshës më të hershme se 18 vjeçare. Kjo si pasoja e manualeve diagnostifikuese të çrregullimeve mendore dhe në anën tjetër hezitimit të profesionistëve të shëndetit mendor (Sharp & Tackett, 2014). Sidoqoftë, manualët diagnostifikuese gjatë viteve të fundit kanë dhënë udhëzime më të qarta sa i përket diagnostifikimit të çrregullimeve të personalitetit tek personat nën moshën 18 vjeçare, duke qenë kështu në të njëjtën linjë me të gjeturat nga hulumtime të ndryshme (APA, 2013; Mulder, 2021; WHO, 2020; Westen et al., 2003). Mirepo, për shkak që procesi nuk ka qenë relativisht i hershëm as në vendet perëndimore, vendet me burime të ulëta si Kosova janë me mbrapa në këtë pjesë. Në fakt në Kosovë nuk ka asnjë të dhënë që ÇKP është duke u diagnostifikuar në moshë më të hershme se 18 vjeçare. Për këtë arsye, projekti “Mhira” në të cilin është i përfshirë Departamenti i Psikologjisë i Universitetit të Prishtinës, është duke e zhvilluar një program kompjuterik që do të ndihmoj profesionistët e shëndetit mendor për diagnostifikimin e ÇKP tek fëmijët dhe adoleshentët.

Në mënyrë që të rritet mundësia që programi kompjuterik të përdoret në të ardhmen nga profesionistët e shëndetit mendor, ai duhet të ju përshtatet sa më shumë nevojave të tyre. Prandaj, qëllimi i këtij studimi ka qenë eksplorimi i nevojave të profesionistëve të shëndetit mendor për programin kompjuterik “Mhira” të përmendur më lartë. Rrjedhimisht, pyetja kërkimore ishte: Cilat janë nevojat e profesionistëve të shëndetit mendor të Kosovës për programin kompjuterik?

Hulumtimi është i dizajnit kualitativ dhe është përdorur analiza e kornizës. Udhëzimet e Kritereve të Konsoliduara për Raportimin e Studimeve Kualitative (COREQ) janë ndjekur që nga kontaktimi i pjesëmarrësve e deri tek raportimi i të dhënave. Të dhënat për hulumtim janë mbledhur nga fokus grupe me udhëzues të temave. Pjesëmarrës në hulumtim ishin 15 profesionistë të shëndetit mendor (87% vajza dhe gra), nga të cilët 8 ishin psikologë shkollorë, 4 psikiatër të fëmijëve dhe adoleshentëve, 1 psikologe klinike dhe 2 edukatore speciale. Udhëzuesi i temave i përdorur në këtë studim ka përfshirë 16 pyetje të cilat kanë qenë të shpërndara në këto seksione: Eksplorimin e Nevojave, Pyetësorët, Pjesën Teknike, Raportin dhe Mjediset e Administrimit. Analizimi i të dhënave është kryer duke e përdorur metodën e kombinuar induktive dhe deduktive të qasjes së kornizës.

Nga analizat janë gjeneruar gjithsej gjashtë tema. Këto tema janë: Opinionet për Mhira-n, Nevojat për Përdorimin e Ardhshëm të Mhira-s, Detajet Teknike të Seancave, Pyetësorët e përfshirë në Mhira, Gjenerimi i Raportit dhe Inkorporimi i Mhira në Punë. Sa i përket opinionëve për Mhira-n, pjesëmarrësit shfaqën vlerësime të përgjithshme pozitive, shprehën se është lehtësim edhe optimizim i punës së tyre, duket i lehtë për të u përdorur dhe do të e rriste bashkëpunimin ndërmjet profesionistëve të shëndetit mendor. Ndërsa, tek nevojat për përdorimin e ardhshëm të Mhira-s, pjesëmarrësve do të ju nevojitet asistencë për pyetësorët dhe asistencë për raportin. Tutje, tek detajet teknike të seancave janë të përmbledhura kategoritë që kanë të bëjnë me rikujtimet për seancat e ardhshme dhe renditja e listës së pacientëve. Sa i përket temës së pyetësorëve, janë shprehur pyetësorët që pjesëmarrësit dëshirojnë të jenë pjesë e Mhira-s, numrin e pyetësorëve dhe kohës ideale për pyetësor.

Gjenerimi i raportit e përfshin automatizimin e raportit, gjatësinë e raportit, formën e gjenerimit të raportit dhe mënyrën e raportimit. Përpos automatizimit të raportit, të gjitha kategoritë e tjera të kësaj teme kanë shfaqur se sa më shumë opsione të përfshihen aq më shumë do të jetë i nevojshëm dhe i përdorshëm programi për profesionistët e shëndetit mendor. Inkorporimi i Mhira-s në punë i përfshin mjediset e përdorimit, përdorimin e vazhdueshëm të

Mhira-s, përdorimin që varet nga disa faktorë të jashtëm dhe disa dyshime nga profesionistët e shëndetit mendor në lidhje me përdorimin e Mhira-s.

Në përfundim, studimi aktual parimisht ndihmon në krijimin e programit kompjuterik. Po ashtu, ky studim jo vetëm që është ndër të parët që i përfshin psikologët shkollor, klinik, psikiatërit e fëmijëve dhe adoleshentëve dhe klinikistët e tjerë në krijimin e një programi të tillë kompjuterik, mirëpo edhe e shtyn përpara hulumtimin dhe praktikën për diagnostifikimin e ÇKP tek fëmijët dhe adoleshentët. Kjo e lehtëson rrugën për ndihmimin e fëmijëve dhe adoleshentëve me ÇKP, pasi që e përmirëson shëndetin e tyre mendor dhe fizik. Për më tepër, hap rrugë për intervenime të reja parandaluese dhe trajtuese në Kosovë. Po ashtu, do të ndihmon psikologët e shkollave dhe psikiatërit e fëmijëve e psikologët klinik rreth mënyrave të diagnostifikimit ose të paralajmërimit dhe referimit. Pra, e lehtëson punën e tyre dhe e ulë subjektivitetin rreth procesit të diagnostifikimit dhe zgjedhjes së pyetësorëve. Gjithashtu, ky hulumtim si hap i parë hap dyert për të e futur programin si shërbim rutinor në praktikat klinike dhe shkollore. E gjithë kjo e prek edhe aspektin e politikbërjes.





